



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE  
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**

**VENDIM**

**Nr. 3, datë 22.01.2015**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE HETIMORE ADMINISTRATIVE**

Në mbështetje të nenit 14 dhe nenit 27 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 për "Kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, dhe nenit 80 e vijues i Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Komisioni Kombëtar Rregullator,

**VENDOSI:**

1. Të nisë procedurën hetimore për marrjen e masave administrative për kundërvajtjen administrative "Ushtrimi i veprimtarisë pa licence", ndaj operatorëve:
  - a. Shoqëria "Ujësjetllës Kanalizime Kavajë" sh.a;
  - b. Shoqëria "Ujësjetllës Kanalizime Vlorë" sh.a;
  - c. Shoqëria "Ujësjetllës Shkodër fshat" sh.a;
  - d. Shoqëria "Ujësjetllës Kanalizime Gjirokastër" sh.a;
  - e. Shoqëria "Ujësjetllës Novoselë" sh.a;
  - f. Shoqëria "Ujësjetllës Skrapar" sh.a;
2. Shoqëritë e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi të njoftohen dhe të thirren për t'u dëgjuar mbi objektin e procedimit, sipas grafikut bashkëlidhur;
3. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Sektori Juridik dhe Marrëdhëniet me Publikun;

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet ne fletoren zyrtare.

**KRYETARI  
Avni Dervishi**